




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E RAHOVECIT/ OPŠTINA ORAHOVAC/ MUNICIPALITY OF RAHOVEC



Njësia e Auditimit të Brendshëm Komuna e Rahovecit



RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS

Për periudhën Janar - Qershor, 2024

03.07.2024

Raporti i punës së NJAB-së për periudhën Janar-Qershor të vitit 2024

Në periudhën Janar – Qershor, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2024, i cili plan është i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm dhe Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për periudhën: Janar – Qershor të vitit 2024, kemi arritur të kryejm dy auditime, dhe nje është në proces.

Drejtoritë e audituara të Planifikuara dhe të realizuara për periudhën Janar – Qershor të vitit 2024

1. Auditimi i Brendshëm në Zyrën e Prokurimit.
2. Auditimi i Performancës, subvencionet në drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
3. Auditimi i Brendshëm në drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Angazhimet tona kryesisht kanë qenë:

- Vlerësimi i objektivave për auditime, sipas shkallës së rrezikshmërisë, është pregaditur Plani Strategjik i NJAB për vitet 2024 – 2026, dhe Plani Vjetor i Punës së NJAB-së për vitin 2024.
- Është pregaditur raporti i gjashtëmujorit të dytë dhe raporti vjetor i NJAB-së për vitin 2023, i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NjQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2023.
- Gjithashtu NjAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve.

Udhëheqësi i NjAB-së

Ruzhdi Kabashi